



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS

MIRATOHET
MINISTRI

Luan MEMUSHI

PROGRAMI I LËNDËS
SË EDUKIMIT MUZIKOR

Klasa III

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

Tiranë, 2005

I. HYRJE

II. SYNIMI

III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

IV. STRUKTURA E PROGRAMIT

V. PROGRAMI SINTETIK

VI. PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

VII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

VIII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

IX. INTEGRIMI

XI. MJETET MËSIMORE

I. HYRJE

Në klasën e tretë njohuritë dhe elementet muzikore do të rimerren dhe do të kultivohen më tej përgjatë këtij programi. Këto elemente do të pasurohen me njohuri të reja, që nxënësi do t'i zbatojë gjatë të kënduarit, luajtjes me instrumente të ndryshme me goditje dhe ORF, përjetimit të muzikës dhe shprehjes së saj, në bashkëveprim me mjete të arteve të tjera. Pra, edhe në këtë nivel, njohuritë muzikore janë të lidhura ngushtë dhe gjejnë zbatim në praktikën muzikore. Ato realizohen duke u ndërthurur përmes veprimtarive praktike artistike në klasë, shkollë ose auditore të ndryshme.

II. SYNIMI

Mësimi i muzikës në klasën e tretë të arsimit të detyruar 9-vjeçar synon t'i aftësojë nxënësit për të përjetuar dhe për t'u shprehur nëpërmjet muzikës, duke shprehur nëpërmjet saj botën e tyre emocionale.

Ky program synon të kultivojë shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar, si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Mësimi i muzikës ka për qëllim që nxënësit në fund të klasës së tretë:

- Të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë, me tematikë të larmishme;
- Të zhvillojnë shprehitë e të kënduarit;
- Të këndojnë me intonacion dhe shprehje;
- Të shoqërojnë këngët apo lojërat muzikore me instrumente të thjeshta ritmike ose melodike, si: shkopinj, shuplaka, ORF etj.;
- Të zhvillojnë elementet dhe konceptet muzikore, nëpërmjet shembujve të thjeshtë muzikorë që këndojnë ose dëgjojnë;
- Të aftësohen për të dëgjuar pjesë muzikore për fëmijë, vokale dhe instrumentale, duke dalluar timbrin e zërave dhe të instrumenteve;
- Të përjetojnë muzikën, nëpërmjet të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë muzikore për këtë nivel.

IV. STRUKTURA E PROGRAMIT

Ky program është i organizuar në 5 linja të cilat zbërthehen si më poshtë:

1. Këndimi
2. Bazat e arsimimit muzikor
3. Luajtja në instrument
4. Dëgjim muzikor
5. Të shprehurit dhe krijimi muzikor

V. PROGRAMI SINTETIK

35 javë	x	1 orë	=	35 orë
1. Këndim				21 orë
2. Bazat e arsimimit muzikor				4 orë
3. Dëgjim muzikor				2 orë
4. Luajtje në instrument				2 orë
5. Shprehje dhe krijim muzikor				3 orë
6. Orë në dispozicion				3 orë

VI. PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

LINJA I. Këndim

21orë

Në këtë linjë të mësohen 9-10 këngë, të cilat të kenë shtrirje brenda oktavës, ku çdo këngë mësohet në 2 orë dhe në disa raste kur është e vështirë në 3 orë.

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës, brenda oktavës do-do²;
- të zhvillojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
 - rregullat e frymëmarrjes,
 - qëndrimi drejt,
 - diksioni,
 - këndimi me ndjenjë,
 - këndimi me intonacion;
 - shqiptimi i saktë i tekstit etj.;
- të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse, duke treguar se e kanë kuptuar tekstin e këngës;
- të këndojnë solo;
- të këndojnë në grup (ansambël/kor);
- të shfaqin shijet e tyre dhe të shprehin mendimin rreth muzikës që këndojnë, si dhe këngëve të ndryshme (këngë për fëmijë, shqiptare ose të huaja, edhe të krahinës);

LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor

4 orë

Në këtë linjë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën ritmike dhe melodike të këngë ose pjesë të ndryshme muzikore:

- të përjetojnë ritme të thjeshta 2/4, 3/4, 4/4 tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;
- të krijojnë modele të thjeshta ritmike;
- të zbatojnë kohën e *theksuar* e të *patheksuar* në këngë ose melodi;
- të regjistrojnë gjatësi ritmike (p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër, të lartë ose të ulët etj., në vargjet e një vjershe, me grafikë).

LINJA III. Luajtja me instrument

2 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të krijojnë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me goditje;
- të shoqërojnë këngët ose meloditë e ndryshme me instrumente ORF;

LINJA IV. Dëgjimi muzikor

2orë

Në këtë linjë nxënësit përmes dëgjimit duhet:

- të përcaktojnë pjesët vokale nga instrumentale duke:
 - dalluar disa karakteristika të tyre;
 - njohur disa instrumente, si: flaut, trompë, çifteli, ksilofon përmes dëgjimit dhe pamjes;

- të rinjohin pjesë muzikore (këngë për fëmijë, popullore valle etj., nga programi që zhvillohet në klasë, si dhe nga ato që transmetohen në TV apo komunitet).

LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor

3 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj.;
- të shpjegojnë me fjalë të thjeshta, ndjenjën që ata provojnë përmes përjetimit të pjesëve me karakter të ndryshëm: të *dhimbshëm*, të *gëzuar*, të *qetë*, *marsh*;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë, duke improvizuar lëvizje të ndryshme në përshtatje me ritmin dhe melodinë;

Objektiv shoqëror

- të listojnë disa veprimtari që zhvillohen në komunitetin e tyre ose në jetën e tyre të përditshme, si: muzika e dëgjuar në televizion, festat familjare, festat apo spektaklet në krahinë apo në vend;
- të listojnë disa fjali, shprehje, që ata përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

Orë në dispozicion

3 orë

VII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Një vend shumë të rëndësishëm në organizimin e orës së mësimit ka formulimi i objektivave, si dhe përcaktimi i metodave që do të përdorë mësuesi, për të qenë sa më i sukseshëm dhe për të arritur objektivat e orës. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë ai, në përputhje me veçoritë e moshës së nxënësve dhe të përmbajtjes së temave të ndryshme mësimore, të bazës materiale mësimore që ka në përdorim. E rëndësishme është që mësuesit të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë nxënësit për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre muzikore. Mësuesit mund dhe duhet të organizojnë veprimtari të larmishme praktike sa të jetë e mundshme, pasi shumë aftësi të përcaktuara në program duhet të arrihen nëpërmjet pjesëmarrjes në to.

Mësuesi u rikujton nxënësve të klasës së tretë tinguj, zhurma të realitetit natyror, të instrumentit muzikor apo edhe të objekteve të tjera, modele të ndryshme ritmike apo melodike. Ai zhvillon veprimtari mësimore, si: lojëra individuale dhe në grup. Mësimi i elementeve muzikore, janë aftësi dhe shprehi që nxënësi i përvetëson nën drejtimin e mësuesit, prandaj ai t'u krijojë mundësinë nxënësve për t'i kuptuar dhe për t'i praktikuar ato shumë mirë në klasë. Nën drejtimin e mësuesit nxënësit në këtë nivel do të rikujtojnë dhe do të përvetësojnë më tej koncepte dhe elemente të reja muzikore, duke zhvilluar kështu shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar apo për t'u shprehur, si dhe për të bërë një analizë të thjeshtë të këngëve apo të pjesëve muzikore. Niveli i dijeve e shprehive të nxënësit përcaktohet jo vetëm nga përmbajtja e lëndës, por edhe nga zbatimi i udhëzimeve e kërkesave të veçanta që ka çdo klasë. Edhe në këtë klasë mësohen këngë në përshtatje me moshën për nga shtrirja (ambitusi) do – do dhe nga përmbajtja, me vlera didaktike, të karakterit fëmijor (natyrën, familjen, shkollën, punën, argëtimin etj.) me ritme të larmishme (vallëzues, marsh, të thjeshta, të përziera) dhe të krahinës.

Këngët zgjidhen në përshtatje me kërkesat e bazave të arsimimit muzikor për edukimin e ndjenjës ritmike dhe melodike. Çdo orë këndimi realizon kërkesa të bazave të arsimimit muzikor. Prandaj këndimi dhe bazat e arsimimit muzikor zhvillohen duke u ndërthurur njëri me tjetrën gjatë orës mësimore.

1. *Edukimi i ndjenjës ritmike të nxënësve.* Dukuritë ritmike përjetohen në formë konkrete dhe më pas arrihet zbatimi i tyre praktik. Mësuesi rikujton dukuritë nga natyra dhe mjedisi, sjell në klasë modele të thjeshta ritmike (2/4, 3/4, 4/4) dhe i zhvillon ato me nxënësit. Gërshetimi i ushtrimeve me elemente ritmike në shoqërimin e këngëve ose të ndonjë loje muzikore fëmimore janë sa më të këshillueshme.
2. *Edukimi i ndjenjës melodike.* Mësuesi zhvillon ndjenjën melodike përmes të kënduarit të këngëve, shembujve shumë të thjeshtë melodikë, ose përmes dëgjimit muzikor. Puna përgatitore për kuptimin e kohës së theksuar dhe të patheksuar është e rëndësishme, prandaj është e domosdoshme, që për të dhënë nocionet e theksit në muzikë, të zgjidhet si shembull një këngë, melodi ose ushtrim i thjeshtë për t'u kuptuar.
3. *Edukimi i shprehive të kënduarit.* Shikohet e pandarë nga aftësitë dhe shprehitë e tjera në edukimin muzikor. Mësuesi punon për të zhvilluar shprehitë e kënduarit gjatë gjithë vitit:
 - Qëndrimi drejt gjatë të kënduarit,
 - Frymëmarrja,
 - Diksioni,
 - Rikujtimi i kërkesave gjatë të kënduarit,
 - Intonacioni i saktë,
 - Dirizhimi kur klasa këndon.
4. *Edukimin me instrumentet dhe marrëdhëniet me to.* Vazhdon më tej puna me instrumentet me goditje dhe ORF. Këto instrumente krijojnë lidhje të afërta me artin muzikor dhe zhvillojnë njëkohësisht ndjenjën ritmike të nxënësve. Instrumenti shton interesin për lëndën, si dhe i ndihmon drejt edukimit të ndjenjës ritmike dhe melodike.
5. *Edukimin për zhvillimin e shprehive gjatë dëgjimit.* Dëgjimi i këngëve ose pjesëve të thjeshta muzikore zhvillon njohuritë e nxënësve jo vetëm në drejtim të muzikës, por edhe në drejtim të kulturës në tërësi, duke i edukuar ata me dëshirën për të dëgjuar. Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilit nxënësi vihet në marrëdhënie me muzikën. Nga njohuritë që kanë tashmë rreth ritmit apo tingujve, ata përjetojnë emocionet që sjell pjesa apo kënga, e deri në vlerësimin e saj me fjalë të thjeshta. Mësuesi vazhdon punën e tij për kultivimin e ndjenjës së të dëgjuarit të nxënësit, duke përdorur gjithashtu formën e bisedës, ku ai sqaron dhe shpjegon karakterin e pjesës, elementet muzikore, si: vetitë e tingullit, ritmin, karakterin etj., njihen dhe përcaktojnë pjesët vokale nga instrumentale; rinjohin disa instrumente muzikore përmes dëgjimit dhe pamjes; dallojnë timbrin e disa instrumenteve, si: flaut, trompë, çifteli, ksilofon, përmes dëgjimit; rinjohin pjesë muzikore (këngë për fëmijë, popullore valle etj., nga programi që zhvillohet në klasë si dhe nga ato që transmetohen në TV). Dëgjimi i pjesëve të shoqërohet me komentimin e tyre, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

VIII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë do të bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi nga veprimtaria praktike, d.m.th. përmes të kënduarit, të luajturit, të analizuarit të pjesëve muzikore etj. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë. Gjithashtu, mësuesi do të ketë si udhëzues edhe dokumentin e standardeve të arritjes për lëtë lëndë.

IX. INTEGRIMI

Ky program jep mundësinë që në tema të veçanta muzika të integrohet me lëndë tjera. Nxënësit mësojnë të ndërtojnë lidhjet ndërmjet muzikës dhe edukimit figurativ, leximit, edukimit fizik, gjuhës shqipe dhe kuptojnë rëndësinë e muzikës si burim kënaqësie dhe si mënyrë komunikimi brenda një kulture dhe me kulturat e tjera. Disa këngë mësuesi i klasës së tretë si njohës shumë i mirë i tërësisë së programit të klasës, mund t'i ndërthurë me lëndë të tjera.

XI. MJETET MËSIMORE

Që të jetë konkret si për nxënësin, ashtu edhe për mësuesin, programi i edukimit muzikor për klasën e tretë, të shoqërohet me bazë materiale, mjete didaktike dhe burime të ndryshme. Ato do të jenë kaseta me materialet didaktike (këngë, pjesë të ndryshme për dëgjim), mjetet me përdorim kolektiv që mund të jenë: magnetofon, fizarmonikë, kaseta të ndryshme, instrumente me goditje ose ORF (sipas mundësive), postera dhe vegla me goditje, si: shkopinj, gurë, lugë, triangolo etj.

Shënim: Mbi këtë program mund të hartohen fletore pune për nxënësit, të cilat do të përzgjidhen më pas nga DAR.